



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 PRILL 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
29. APRILA 2008. GODINE

Prill – April
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 17 prill 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për taksën e vendosjes.
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale,
11. Shqyrtimi i propozimit të grupit Parlamentar të AKR-së për ndërrimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji.

D n e v n i r e d

1. Usvajanje zapisnika sa plenarne sednice od 17. aprila 2008,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 2002/9 o Inspektoratu rada,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 2003/15 o šemi socijalne pomoći,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o taksi smeštaja
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o dopuni izmeni Zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o konačnom i maturskom ispitu,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o zaradama bivših visokih zvaničnika,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izjavi u vezi porekla imovine visokih javnih zvaničnika,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni zakona o krivičnom postupku,
11. Razmatranje Predloga Parlamentarne Grupe AKR-ja za zamenu člana Komisije za obrazovanje, nauku i tehnologiju.

A g e n d a

1. Approval of the minutes from plenary session on 17 April 2008,
2. Time for parliamentary question,
3. Second review of the Draft law on amendment and supplementation of the Law nr. 2002/9 on Labour Inspectorate,
4. Second review of the Draft law on amendment and supplementation of the Law nr. 2003/15 on Social Assistance Scheme,
5. Second review of the Draft Law on Accommodation Tax.

6. Second review of the Draft law on amendment and supplementation of the Law on execution of penal sanctions,
 7. Second review of the Draft Law on Final and Matura Exam,
 8. Second review of the Draft Law on Benefits to Former High Officials,
 9. Second review of the Draft Law on Declaration and Origin of the Property of Public Senior Officials,
 10. Second review of the Draft law on amendment and supplementation of the Code of Criminal Procedure,
 11. Review of proposal made by Parliamentary Group of AKR in changing the member of the Committee on Education, Science and Technology.
-

Seanca filloi punën në orën 11,00

Seancën e drejtoi zoti **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës!

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 88 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6 pika 2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, në pajtim me rregullat procedurale, Grupi Parlamentar i AKR-së, ka kërkuar që në seancën e sotme të bëhet Propozimrezoluta për kundërshtimin e mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë.

Kryesia e Kuvendit, në takimin e sotëm ka miratuar propozimin e Grupit Parlamentar të AKR-së dhe njëherësh ka kërkuar që teksti i Rezolutës të harmonizohet në takimin e përbashkët me shefat e grupeve parlamentare gjatë mbajtjes së seancës plenare. Kjo radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës.

Gjithashtu, Kryesia në mbledhjen e sotme shqyrtoi kërkesën e deputetit Berat Luzha, e mbështetur nga 5 deputetë të tjerë, me të cilën propozohet që kjo çështje të procedohet në seancën e radhës, në pajtim me Rregullën 6.5 të Rregullores së Punës të Kuvendit.

Andaj, të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Lidhur me rendin e ditës, fjalën e ka kërkuar Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zotëri ministra,

Ne, të Grupit Parlamentar të PDK-së, jemi dakorduar që sot të kërkojmë nga seanca që të aprovojë kërkesën për t'u hequr nga rendi i ditës Projektligji për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë, duke menduar se ky projektligj ka nevojë të përplotësohet, sepse nuk i kemi vetëm 3 ish-zyrtarë të lartë. Andaj, në bazë të kësaj kemi menduar që t'u jepet edhe

pak kohë komisioneve të caktuara që ta përpunojnë dhe analizojnë mirë këtë dhe ta mbajmë pastaj një seancë më vonë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Sigurisht që Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet qëndrimet e Kryesisë, të miratuara në këtë mëngjes, dhe do t'i koordinojë në mes shefave të grupeve parlamentare angazhimet rreth asaj rezolute.

E kam një kërkesë, mund të them teknike më shumë, që pikat 6, 9 dhe 10 të radhiten me prioritet, pas pyetjeve parlamentare, në mënyrë që ministrja Kelmendi të jetë prezente gjatë votimit të amendamenteve të këtyre tri ligjeve. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është lajmëruar shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Ardian Gjini. Urdhëroni, zoti Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar! Jemi dakord për çështjet që u përmendën, por tërheqja e Ligjit për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë mendoj se nuk duhet të bëhet. Ligji duhet të procedohet për shkak se është leximi i dytë dhe më vonë mund të amendohet, për shkak se po na devijon e gjithë procedura në Kuvend.

Ne kemi tërhequr vërejtjen edhe më herët se ligjet kanë ardhur në Kuvend pa u lexuar dhe pa u shqyrtuar fare nga Qeveria, kanë ardhur me data të cilat nuk kanë korresponduar me datën e sodit dhe tash, pasi e kemi kryer gjithë këtë procedurë, mendojmë se duhet të shkojmë më tutje dhe më vonë Qeveria të amendojë ligjin e jo të na tërhiqet prej Kuvendit në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar! Flas në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës. Ne, si Komision, në aspektin buxhetor e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe kështu, si është propozuar, nuk përmban implikime buxhetore.

Dilema e këtij komisioni ka qenë se, sikur po tentohet që në mënyrë parciale të zgjidhen çështje që janë shumë të rëndësishme, siç është kjo dhe e përfitimeve të ish-zyrtarëve të lartë dhe si Komision kemi konsideruar ta bëjmë një grup dhe ta autorizojmë që bashkë me Komisionin për Legjislacion ta shqyrtojë edhe një herë këtë Projektligj dhe ta plotësojë, sepse kemi konsideruar se në Kosovë ka më shumë ish-zyrtarë të lartë, që mund ta merrni edhe me Kornizë Kushtetuese dhe nëse jo, atëherë me Kushtetutën që është miratuar dhe që do të zbatohet pas qershorit, nuk kemi vetëm 3 ish-pozita të larta. Kjo edhe Qeverinë edhe Kuvendin do ta qesë në pozicione të tilla që për çdo rast veç e veç do të bëjë ligje të tilla. Të mendohet qartë e mirë dhe të bëhet një ligj që rregullon këtë materie në tërësi dhe jo në mënyrë parciale. Prandaj, jo që të tërhiqet sot nga rendi i ditës, por këto dy komisione dhe veçanërisht Komisioni për ligjet të punojë dhe shqyrtojë.

Unë po e përmend vetëm një fakt. Sipas këtij projektligji, si zyrtar i tretë me radhë, kemi kryetarin e Gjykatës Supreme. Sipas Kushtetutës, autoritet para kryetarit të Gjykatës Supreme është kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe le të mendohet mirë për këto pozita,

pastaj ku është pozita e Ombudspersonit e të tjera, e të tjera, që nesër do të na duhet të nxjerrim ligje të tilla.

KRYETARI: Faleminderit! Ombudspersoni nuk është zyrtar i lartë. Ai zgjidhet me konkurs, prandaj mendoj se në një masë ke të drejtë, por jo në këtë rast. Me Rregullën 30 mocionet procedurale mund të shtyhen, prandaj unë i vë në votim të dy kërkesat.

Pra, e kemi pikën e tetë: - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përfitimet e zyrtarëve të lartë. Është ky propozim i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Do të votojmë me ngritjen e dorës.

Kush është që të shtyhet leximi i dytë për këtë Projektligj?

Sekretaria le t'i numërojë votat. Faleminderit!

Kush është “kundër”?

Konstatoj se me shumicë votash “për” dhe me 4 vota “kundër”, miratohet propozimi që të shtyhet shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë.

Tani kemi propozimin e dytë nga Lidhja Demokratike e Kosovës që pika 6, 9 dhe 10 të shqyrtohen pas pikës – Pyetje parlamentare.

Kush është “për”? Faleminderit!

A ka kush “kundër”? Nuk ka.

Me shumicë absolute votash u miratua propozimi dhe me këtë ndryshon radhitja e shqyrtimit të ligjeve në fjalë.

Tani vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

**- Miratimi i Procesverbalit të Seancës plenare, të mbajtur
më 17 prill 2008**

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se Procesverbali i Seancës plenare, të mbajtur më 17 prill 2008, si dhe Transkripti nga kjo seancë, iu janë shpërndarë deputetëve me kohë.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në Procesverbal?

Urdhëroni! E ka fjalën deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar! Përshëndetje!

Mendoj në faqen 4, për një gjysmë fjalie plotësim. Pas fjalisë që shkruan aty: “në mënyrë që të mos kemi cenim të sovranitetit dhe integritetit të vendit tonë.” të shtohet kështu: “Qeveria dhe UNMIK-u të veprojnë në pajtim me detyrimet dhe mandatet që iu takojnë”. Është formulimi që është thënë, por mungon këtu në Procesverbal, lidhur me zgjedhjet që i ka propozuar Serbia.

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është lajmëruar deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar! Jam i lutur nga deputeti Adem Salihaj, i cili mungon, të them këtë sa vijon.

Te Projektligji për ndërmjetësimin, është shkruar Jonuz Salihu, si deputet i LDD-së, kurse duhet të jetë Adem Salihaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka ndokush tjetër i paraqitur për fjalë?
Nuk ka. Atëherë, me korrigjimet e theksuara, e vë në votim Procesverbalin.
Kush është “për”?
A ka kush “kundër”? Nuk ka.
A ka abstenime? Nuk ka. Faleminderit!

Konstatohet se me shumicën absolute të votave, Kuvendi miratoi Procesverbalin e Seancës plenare të datës 17 prill 2008.

Pika e dytë e rendit të ditës:

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 26 pika 1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Në afatin e përcaktuar me Rregulloren, janë parashtruar 21 pyetje parlamentare, të cilat do të procedohen sipas kohës së parashikuar.

Ju njoftoj se për shkak të kohës së kufizuar, së pari do të procedohen nga një pyetje e secilit deputet, ndërsa më pas do të procedohen edhe pyetjet e deputetëve të cilët kanë parashtruar më shumë se një pyetje.

Para se të fillojmë me parashtrimin e pyetjeve, ministri i Arsimit, zoti Enver Hoxhaj, e ka një kërkesë që pyetja e tij, që është e dhjeta me radhë, të jetë në fillim për shkak se ka një takim zyrtar.

A pajtoheni me këtë ndryshim?
Kush është “për”? Faleminderit!
Atëherë, ftoj deputeten Njomza Emini – AKR, të lexojë pyetjen për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Si duket, nuk parashtrohet pyetja. Nëse jo, konsiderojmë se kjo çështje u krye.

Vazhdojmë sipas radhës.

Pyetja e parë, deputeti Ibrahim Makolli – AKR, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi.

Zoti deputet, mund ta lexoni pyetjen.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar kolegë,
Zotëri ministra, zëvendëskryeministër,
Çështja është se një numër i madh i qytetarëve tanë gjenden në vuajtje të dënimit në vendet e tjera, sidomos në vendet përreth Kosovës. Në mbështetje të dokumenteve ndërkombëtare, qytetarët e një vendi kanë mundësi që vuajtjen e dënimit ta bëjnë edhe në vendin e origjinës.

Pyetja ime është: Çka është duke ndërmarrë Qeveria e Kosovës, konkretisht Ministria e Drejtësisë, që ta mundësojë një çështje të tillë? Faleminderit!

KRYETARI: Zonja ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari Kryetar i Parlamentit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Në pyetjen e zotit Makolli do të përgjigjesha shumë shkurt. Ministria e Drejtësisë akoma nuk i ka kompetencat për t'u marrë me ndihmën juridike ndërkombëtare. Kjo çështje vërtet është e rregulluar me dispozitat e Kodit të procedurës penale, sipas të cilit duhet të ekzistojë marrëveshja ose kontrata me shtete ku gjendet shtetasi i Kosovës në mbajtje të dënimit, mirëpo tani për tani, derisa nuk transferohen kompetencat e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, Ministria e Drejtësisë nuk ka kurrfarë kompetencash për këtë çështje.

Sido që të jetë, ka të burgosur apo familjarë të tyre që i janë drejtuar kësaj Ministrie lidhur me këtë çështje dhe kjo Ministri, pa humbur kohë, menjëherë ia ka proceduar lëndën, çështjen Departamentit të Drejtësisë dhe ka ndodhur që janë bërë ekstradime, përkatësisht kanë ardhur shtetasit e Republikës së Kosovës nga vende të tjera për ta mbajtur dënimin këtu.

Kemi edhe një rast kur ka qenë i burgosur me një fletarrest të Serbisë, nga gjykatat paralele atje, një shtetas i Kosovës në Holandë, kemi arritur që nëpërmjet Departamentit të Drejtësisë ai shtetas të lirohet, sepse ka qenë i akuzuar për terrorizëm me një aktakuzë të një shteti të huaj. Kjo ishte e tëra.

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Nuk ka.

Kalojmë në pikën e radhës. Deputetet Rita Hajzeraj dhe Gjylnaze Sylja, pyetje të njëjtë për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Rita Hajzeraj pyetjen e ka bërë më 1 prill 2008, Gjylnaze Sylja më 14 prill 2008.

A mund të merreni vesh cila prej juve do ta lexojë pyetjen?

(Reagim – pa kyçje të mikrofonit)

Unë e kam fjalën për pyetjen që e keni bërë, Rita më 1 prill, ju më 14 prill. Cila po e lexoni pyetjen. Pyetja është e njëjtë. Urdhëroni, e ka fjalën deputete Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar ministra,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar e të respektuar deputetë,

Në bazë të Rregullës 26.2 të Rregullores së Punës të Kuvendit, unë i kam parashtruar pyetje zotit Kryeministër. Besoj se mund të përgjigjet edhe zëvendëskryeministri që është prezent këtu.

Çështja është: Serbia po planifikon që Kosovën ta shpallë një zonë zgjedhore për organizimin e zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës.

Për zotin Kryeministër, pyetja është: Ai ka deklaruar se organizimi i zgjedhjeve serbe nuk do të lejohet të mbahet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Cili është qëndrimi i tij rreth kësaj çështjeje?

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Kryeministri, besoj edhe institucionet e tjera, përfshirë edhe Presidentin, me kohë kanë dhënë qëndrimin e vet. Qëndrimi i tyre është i koordinuar plotësisht edhe me institucionet vendore, por edhe me ato ndërkombëtare.

Kosova është shtet sovran dhe i pavarur dhe çdo zgjedhje që bëhet nga shtetet e tjera është e paligjshme, jolegale dhe jolegjitime do të shpallet. Kemi marrë dy masa konkrete. E para, kemi fituar mbështetjen ndërkombëtare, të UNMIK-ut në veçanti, i cili është përgjegjës për shpalljen e zgjedhjeve në Kosovë dhe, e dyta, kemi garantuar se ndërtimi i institucioneve në Kosovë nuk mund të bëhet mbi bazën e atyre zgjedhjeve.

Qeveria e Kosovës nuk e ka logjikën e përdorimit të dhunës, por delegjitimimin e tyre do ta bëjë në tërësi.

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Deputetja Rita Hajzeraj, e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ: Zoti zëvendëskryeministër, Ju zotoheni se nuk do të lejoni zgjedhje të serbëve në Kosovë në bashkëpunim me instancat tjera që jeni marrë vesh. Mirëpo, kohëve të fundit, liderët serbë vijnë dhe mbajnë mitingje parazgjedhore në Kosovë. A mendoni se cenohet sovraniteti i shtetit të Kosovës dhe a vihet në pikëpyetje autoriteti i institucioneve të Kosovës? Kjo më intereson.

KRYETARI: Urdhëroni zoti zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit! Ne kemi qenë dëshmitarë se disa e kanë keqpërdorur, do të thoja pozitën në raport me UNMIK-un duke ardhur në Kosovë dhe duke shfrytëzuar Kosovën për fushata elektorale, ndoshta në një mënyrë ose në mënyrën tjetër, duke dashur të tregojë sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën. Ato vizita nga ne janë treguar si të panatyrshme, nuk kanë kontribuar në raportin ndërshtetëror në mes Kosovës dhe Serbisë në të ardhmen dhe mund të themi se efekti ka qenë krijimi i iluzioneve për minoritetin serb, por përkundrazi nuk ka pasur asnjë efekt tjetër. Ne kemi qenë dhe jemi të kujdesshëm që të mos japim deklarata që tensionojnë situatën, por jemi të bindur se pas 15 qershorit ata do ta respektojnë protokollin shtetëror.

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja e tretë, deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Është i njohur fakti se në Republikën e Kosovës është shkalla e lartë e vdekshmërisë së foshnjave dhe sidomos është shkalla e lartë e mortalitetit perinatal. Kjo pasqyron mosefikasitetin e sistemit shëndetësor. Prandaj, pyes ministrin Alush Gashi,

çfarë ka bërë Ministria e Shëndetësisë që të zvogëlojë shkallën e lartë të vdekshmërisë së foshnjave?

KRYETARI: Ministri Alush Gashi e ka fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar! Faleminderit zonja Gjylnaze për këtë pyetje shumë përmbajtjesore!

Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar në sigurimin e shërbimeve shëndetësore në të gjitha nivelet për një kujdes sa më cilësor për nënën dhe fëmijën, duke përfshirë edhe shëndetin riprodhues.

Prioritet numër një në Ministrinë e Shëndetësisë është fillimi i shëndetshëm i jetës. Vdekshmëria është ende e lartë, por krahasuar me vitin 2000, fatmirësisht ka rënie.

Që në fillim të mandatit tim, në Ministri të Shëndetësisë është themeluar ajo për të cilën këtu kanë bërë përpjekje tetë vite, e s'kanë arritur – është themeluar Zyra për shëndetin e nënës dhe të fëmijës dhe shëndetin riprodhues.

Masat e ndërmarra, zonja deputete, nga Ministria e Shëndetësisë, janë këto. Kemi:

- Ligjin për shëndetin riprodhues;
- Ligjin për abortin;
- Ligjin për gjdhënie;
- Strategjinë për shëndetin riprodhues;
- Është miratuar Rregullorja për të ushqyerit dhe Kodi për ta zëvendësuarit e qumështit të gjirit;
- Janë shtypur dhe shpërndarë fletoret për shëndetin e shtatzënës dhe fëmijëve, që janë vlerësuar shumë lartë si mjet i përcjelljes në shëndetin e nënës dhe të fëmijës;
- Është hartuar dhe zyrtarizuar Udhëzimi administrativ për plotësimin e fletoreve të shtatzënisë.

Angazhimi ynë i plotë është për përplotësimin e resurseve me profesionistë, sigurimin e pajisjeve. Fatmirësisht, kemi të dhëna të prekshme për rindërtimin e objekteve për neonatologji.

Megjithatë, mbetet vazhdimi i përkushtimit për plotësim të mungesës së neonatologëve, si dhe themelimi i Qendrës Kombëtare të Neonatologjisë në Prishtinë, duke bashkuar kapacitetet ekzistuese të kuadrit, të hapësirës, të pajisjes së neonatologjisë në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike dhe të asaj të Pediatrisë, si dhe themelimin dhe pajisjen e mjekësisë intensive me pediatriinë. Kjo do të bëhet më lehtë me mbështetje dhe koordinim nga donatorët, në veçanti nga USAID-i dhe Universiteti Dotmurthit të SHBA-ve. Janë këto disa nga veprimet që ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë, e përkrahur nga Qeveria.

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Deputetja Gjylnaze Sylja, ka pyetje shtesë.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, me gjithë masat e marra, megjithatë shkalla ngelë e lartë. A ka ndonjë veprim ndërministror dhe a keni insistuar që Qeveria ta bëjë prioritet këtë punë?

KRYETARI: Ministër, mund të përgjigjesh.
Ministri Alush Gashi e ka fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit! Siç ju kujtohet, në Programin e Qeverisë, ky Kuvend ka insistuar që shëndetësia të jetë një prej prioriteteve parësore të qeverisjes dhe Qeveria e Kosovës këtë vendim të Kuvendit e ka marrë me seriozitet të plotë.

Lidhur me pyetjen, ne me plotë drejtë kemi pse të brengosemi se është vdekshmëria më e larta në Evropë. Por, ajo çka na inkurajon është se kjo rënie prej vitit 2000 deri më tani është për 30%. Kemi rekomandime që t'i bashkojmë këto dy institucione në një me tërë ekspertizën si dhe në nivel të vendit ta kemi transportin e siguruar prej një qendre në qendrën tjetër nga ekipi i specializuar dhe i përgatitur. Natyrisht, kjo ka edhe shumë të bëjë me zhvillimin e tërësishëm të vendit tonë, me zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për nënën dhe fëmijën. Ju faleminderit në pyetje!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!
Pyetja e radhës, deputeti Driton Tali, pyetje për ministren e Energjetikës dhe të Minierave, zonjën Justina Pula. Ministrja nuk është këtu, zoti deputet. A doni ta lexoni pyetjen?

DRITON TALI: Po, mund t'ia drejtoj, nëse më lejohet, edhe zëvendëskryeministrit, për shkak se ka të bëjë me qëndrimin e Qeverisë, zoti Kryetar. Nëse pranon zoti zëvendëskryeministër.

KRYETARI: Keni të drejtë të bëni pyetjen, ky ka të drejtë të përgjigjet ose jo.

DRITON TALI: Atëherë jo, atëherë do të pres, pra. Herën tjetër do t'ia adresoj, kështu, në mënyrë të saktë, kryeministrit dhe zëvendëskryeministrit.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!
Pyetja e radhës, deputeti Hajdin Abazi, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar.
Deputeti Hajdin Abazi e ka fjalën.

HAJDIN ABAZI: Përshëndetje të nderuar kolegë,
Përshëndetje i nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Unë edhe herën e kaluar e kam shtruar pyetjen lidhur me bifurkacionin e lumit Nerodime, në Ferizaj, çka mundemi ne të bëjmë aktualisht për ta shpëtuar. Ndërsa, tani jam i interesuar të dijë se çfarë ka bërë dhe çfarë mund të bëjë Qeveria që ky raritet i vetëm në Evropë të futet nën përkujdesjen e UNESCO-s.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Yagcilar e ka fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar deputetë,
Kolegë ministra,
Zotëri deputet Abazi,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor fenomenin e bifurkacionit e ka trajtuar si vlerë të trashëgimisë natyrore të rëndësisë së veçantë sipas Ligjit për mbrojtjen e natyrës, Ligji 2006/22.

Në pyetjen e kaluar, gjithashtu, u përgjigja se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka propozuar një projekt për vitin 2008 në vlerë të përafërt 50 mijë euro, të paraparë për financim nga buxheti i Kosovës.

Po ashtu, Kuvendi Komunal i Ferizajt ka përgatitur një projekt për Konferencën e donatorëve, i cili kap shumën prej afërsisht 419 mijë euro. Po që se ndahen mjetet, do të ketë veprime të tjera që do të pasurojnë dhe do ta bëjnë funksional fenomenin ekzistues e bifurkacionit. Mendojmë që me zbatimin e projektit të planifikuar do të bëhet funksional ky bifurkacion, në mënyrë që më vonë të ketë mundësi t'u propozohet organeve, si UNESCO-s dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe të shfrytëzohet për zhvillimin e turizmit, si vend i një rëndësie të veçantë. Kjo është përgjigja, zoti Kryetar.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputet, a keni pyetje shtesë? Faleminderit!

Kalojmë në pyetjen e radhës. Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Zotëri deputet, e ke fjalën!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të çmuar kolegë deputetë,

Zotëri ministër i Shëndetësisë, kam një pyetje që ka të bëjë me fatin e një institucioni shumë të rëndësishëm shëndetësor, Banjën afër Pejës, por që ndodhet në territorin e komunës së Istogut. Kjo banjë shëruese, me ujëra termale dhe qendër të rehabilitimit, ka qenë e njohur jo vetëm në vendin tonë, por edhe më gjerë. Aktualisht, ndodhet në një situatë tejet të palakueshme. Pjesa shëndetësore mezi funksionon, kurse për pjesën turistike as që mund të flasim që ekziston. Janë tendenca nga AKM-ja që të privatizohet, si tërësi, duke e ditur rëndësinë e këtij institucioni dhe faktin se ujërat termale janë pasuri kombëtare, tani të garantuara edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Si e sheh Ministria e Shëndetësisë dhe ju, si ministër, fatin e këtij institucioni tejet të rëndësishëm jo vetëm për Rrafshin e Dukagjinit...

KRYETARI: Zoti ministër e ka fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zotëri deputet, Naser Rugova,

Enti Shëndetësor i Mjekësisë Fizikale dhe Rehabilitimit, Banja e Pejës, është në komunë të Istogut dhe është regjistruar si Ent për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim në Gjykatën Ekonomike në Gjakovë, më 4 qershor të vitit 1986, numri i regjistrimit 298/86. Themelues ka qenë BVI-ja Krahinore për Shëndetësi e Kosovës, me shifër të veprimtarisë numër 130-132, në bazë të shënimeve të Entit statistikor të vendit tonë.

Me vendim të UNMIK-ut 1/199 të 25 qershorit 1999 për autorizime të Administratës së Përkohshme në Kosovë, gjithë prona e tundshme dhe e patundshme kalon në Administratën e UNMIK-ut, respektivisht në të famshmen AKM, sipas nenit 2 dhe 3 të

Rregullores së UNMIK-ut mbi krijimin e AKM-së. Pra, administrimi i pronës publike dhe shoqërore kalon në kompetencë të AKM-së, kompetenca këto të plota lidhur me transformimin e ndërmarrjes në pronësi shoqërore, publike dhe menaxhimin e kësaj prone.

Andaj, AKM-ja me këtë Rregullore ka siguruar autorizime të pakufizuara në procesin e privatizimit dhe të menaxhimit të këtij procesi, e në kuadër të kësaj edhe të Banjës së Pejës.

I nderuari zoti deputet,

Sipas Ligjit të shëndetësisë së Kosovës të vitit 2004, rehabilitimi mjekësor është pjesë integrale e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, i përcaktuar në kategoritë e institucioneve dytësore të kujdesitë shëndetësor. Gjatë vitit të kaluar, në veçanti gjatë vitit 2006, Ministria e Shëndetësisë dhe udhëheqësit e Entit Shëndetësor të Banjës së Pejës kanë kërkuar që ky institucion të konsiderohet objekt me rëndësi të veçantë dhe mos të hyjë në listën e privatizimit të AKM-së, por më 16 gusht të vitit 2006, Qeveria e Kosovës, me qëndrimin nr. 05-211, të nënshkruar nga Kryeministri, i zotëri Agim Çeku, kërkon nga AKM-ja që privatizimi i Banjës së Kllokotit dhe i Banjës së Pejës të bëhet sipas spinofit special. Sipas raporteve të Drejtorati të Entit të Mjekësisë për terapi fizikale dhe rehabilitim në Banjë të Pejës, ajo funksionon si një objekt i quajtur stacionar termal, i cili ka 180 shtretër. Stacionari numër 1 dhe Stacionari Oniks janë të demoluara dhe jashtë funksionit në plotëni. I pari si pasojë e ...

KRYETARI: Faleminderit për përgjigjen! Ka pyetje shtesë? Deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Zotëri ministër,

Duke e ditur rëndësinë e këtij institucioni shëndetësor rehabilitues dhe duke e ditur se ujërat termale janë pasuri kombëtare, ju duhet të merrni masa si Qeveri e shtetit të pavarur të Kosovës, nën një, dhe nën dy, një sugjerim. Përgatitni një projekt serioz për Konferencën e shumëpritur të donatorëve, sepse, siç e dini, ai institucion ka të bëjë edhe me zhvillimin ekonomik të një regjioni dhe të regjionit të tërë, sidomos për komunën e Istogut. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Zotëri deputet,

Shëndetësia dhe turizmi termal i pjesës së Evropës Qendrore është treguar shumë i suksesshëm. Në këto 7 – 8 vitet e fundit, Sllovenia me këtë investim të qëlluar, duke e mbajtur si pronë të veten, e tejkaluar edhe Hungarinë. Ministria e Shëndetësisë kërkon nga AKM-ja që ky burim mos të privatizohet, por të privatizohet sipas Spinofit special vetëm objekti i Oniksit, ku së paku 30% ne do t'i kishim për veteranët e luftës dhe për pensionistë. Shpresoj që AKM-ja, kjo e tashmja, dhe ajo e ardhshmja, do ta marrë në konsiderim.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për zëvendëskryeministrin, zotin Hajredin Kuçi.

Deputete, lexojeni pyetjen e 2 prillit 2008!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar! Më vjen mirë që e patë atë planin e punës që e keni punuar.

Qeveria e Rusisë dhe, po ashtu, presidenti Putin, kanë dërguar ndihma humanitare në Kosovë për qytetarët serbë të Kosovës. Ju zoti zëvendëskryeministër, në emër të Qeverisë keni deklaruar se donacionet nga vendet e tjera duhet të koordinohen dhe menaxhohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, gjegjësisht nga institucionet qendrore. Prandaj, pyes zëvendëskryeministrin Kuçi, si e ka bërë Qeveria e Kosovës koordinimin dhe njëkohësisht kontrollin e ndihmave humanitare për qytetarët serbë? Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministri do të përgjigjet.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zonja deputete!

Ne, posa e kemi marrë informatën që Qeveria e Rusisë ka ndarë një donacion, kemi takuar në radhë të parë UNMIK-un, pastaj ministrin e Shëndetësisë dhe të Bujqësisë dhe kemi kërkuar që, në radhë të parë, të konstatojmë se ndihmat për Kosovën janë të mirëseardhura dhe donacionet, po ashtu. Natyrisht, ne përkujdesemi për gjithë qytetarët, jo vetëm për serbët, po për gjithë qytetarët e Kosovës. Në këtë drejtim kemi kërkuar që të respektohen në tërësi procedurat e parapara në vendin tonë, që nënkupton kontrollimin e tyre dhe menaxhimin. Ato ndihma kanë ardhur përmes Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, të kontrolluara nga inspektorët tanë adekuatë dhe mendoj që kjo ka shkuar sipas procedurave të parapara.

Një problem që mund të jetë në të ardhmen, do të jetë balancimi i tregut që besojmë në të ardhmen do ta kuptojnë, nëse këto donacione do të tejkalojnë formën adekuate të balancimit të tregut, atëherë duhet të shikojmë raportin me çmime që mund të jenë në vendin tonë. Sido që të jetë, ndihmat janë të mirëseardhura, por do të jenë të koordinuara gjithmonë nga Qeveria dhe të inspektuara nga organet kompetente.

KRYETARI: Faleminderit! Ka pyetje shtesë?
Gjylnaze Sylja ka pyetje shtesë.

GJYLNAZE SYLA: Zoti zëvendëskryeministër, a i është nënshtruar kontrollit doganor i gjithë malli dhe a ka pasur ose a ka njohuri Qeveria se ka pasur mall që i ka kaluar afati, a është ndërmarrë diçka?

KRYETARI: Përgjigjen e jep zëvendëskryeministri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: E para, besoj që jeni të informuar se ato kanë kaluar përmes kufirit, jo nga Albaniku apo Leposaviqi, por përmes kufijve ku ne e kemi kontrollin e plotë. E dyta, kanë kaluar përmes Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe, e treta, janë inspektuar në detaje. Besoj që e keni parë në mediat e informimit publikë. Pra, i kemi kryer të gjitha obligimet që është paraparë me ligj, këtë do ta bëjmë edhe në të ardhmen. Të gjitha veprimet që janë jashtë ligjit, ne nuk do të tolerojmë në vendin tonë.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputeti Smaka, parashtrojeni pyetjen!

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra, Kryeministër,
Deputetë të respektuar,

Në gjitha vendet e përparuara, e Kosova mëton për qenë një ndër vendet e përparuara të botës, ekstra profiti merret edhe vendoset në buxhet, e së andejmi distributohet në pozicionet e caktuara me ligj.

Ne i kemi disa organizata biznesore, si quhen korporata, ndërmarrje publike, që realizojnë ekstra profit jo në saje të punës, po në saje të pozitës monopoliste në treg. Atje janë pagat jashtëzakonisht të larta, janë në disproporcion me moralitetin, me legalitetin. Çfarë ka ndërmend Qeveria të bëjë në mënyrë që ekstra profiti të merret, të vendoset në buxhet dhe të orientohej, po e zëmë, për pensionistët, për rastet sociale, për invalidët e luftës, e tjera, e tjera? Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, ke përgjigje? Urdhëro!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, profesor Smaka për pyetjen që e keni bërë!

Ne, si Qeveri, kemi qenë të njoftuar sidomos me mjetet që i ka Trusti pensional, me mjetet që ka i Posta momentalisht, por edhe me mjetet që janë të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Kemi bërë kërkesën nga UNMIK-u që të bëhet një bartje e tillë, por ne kemi bërë, besoj, edhe një veprim të drejtë dhe shumë logjik, edhe juridik. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në një nen thuhet: “Të gjitha pronat apo pronësitë e ndërmarrjeve apo të agjencive të tjera të vendit që gjinden në Kosovë dhe jashtë Kosovës, pas 15 qershorit do t’i kthehen Kuvendit të Kosovës, respektivisht Qeverisë”. Ne jemi të bindur që kjo do të ndodhë dhe jemi të bindur që shpërndarja e tyre do të bëhet sipas propozimit që jep Qeveria e Kosovës, por me miratimin, gjithsesi, të Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Ka pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.
Deputetja Pantina e parashtron pyetjen.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, i nderuari Kryetar i Kuvendit!

Para se t’ia parashtroj pyetjen Kryeministrit të Kosovës, unë vetëm t’ju kujtoj se në seancën e fundit kam pasur edhe një pyetje për ministrin e Bujqësisë, mirëpo, në mungesë të ministrit të Bujqësisë, nuk kam qenë në gjendje të parashtroj pyetjen, prandaj lus të më bëhet e mundur ta parashtroj pyetjen sot, me qenë se edhe ministri është prezent. Pyetjen e kam të protokollar, e kam me vete, nëse doni mund ta dëshmoj. A mund ta parashtroj pyetjen?

KRYETARI: Për Kryeministrin ose për ministrin?

MYRVETE PANTINA: Për ministrin e Bujqësisë.

KRYETARI: Mirë, pasi është ministri këtu, parashtroje pyetjen!

MYRVETE PANTINA: Faleminderit!

Prodhimtaria bujqësore është një segment i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik në Kosovë, por ajo ende është tradicionale dhe karakterizohet me rendimente të ulëta. Ristrukturimi i prodhimit bujqësor është i domosdoshëm duke marrë parasysh vështirësitë

e theksuara të prodhuesve bujqësorë për të përballuar konkurrencën në tregun e vendit, e aq më tepër në eksport.

KRYETARI: Ministri i Bujqësisë e ka fjalën.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Pyetja ka qenë, pse s'ka subvencione në bujqësi për vitin 2008, apo?

I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar ministra dhe zotëri deputetë,

Për vitin 2008 Ministria e Bujqësisë buxhetin e ka gjetur të planifikuar. Kemi pasur një mundësi të vogël të rishikimit, mirëpo mundësitë e lëvizjeve buxhetore kanë qenë shumë të vogla. Shumë seriozisht e kemi diskutuar në Qeveri, mirëpo për shkak të Konferencës së donatorëve që do të mbahet së shpejti, atëherë orientimi ynë ka qenë të orientohemi në përgatitjen për Konferencën e donatorëve. Përveç kësaj, ne edhe për kornizën afatmesme të buxhetit të shpenzimeve të Kosovës, do me thënë, kemi paraparë subvencione edhe nga buxheti i Kosovës, por edhe nga donacionet. Prandaj, angazhimi ynë do të jetë shumë i fuqishëm që në të ardhmen të ketë subvencione, por për vitin 2008 arsyeja ka qenë kjo. Faleminderit!

KRYETARI: Ka pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër, a ka ndonjë analizë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për nevojat të subvencioneve për bujqësinë?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Ne kemi përgatitur projekte, sepse e dimë shumë mirë gjendjen në bujqësi e cila është në Kosovë. Projektet për Konferencën e donatorëve që ne i kemi përgatitur kapin shumë mbi 280 milion euro. Ndërkaq, për 3 vitet e ardhshme nga buxheti i Kosovës do të kërkojmë rreth 13 milion euro vetëm për subvencione direkte, do me thënë, ka analiza në të gjithë sektorët që i përkasin bujqësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete Pantina, parashtroje tani pyetjen e re për Kryeministrin!

MYRVETE PANTINA: Lufta e vitit 1999 i la shumë njerëz pa dokumente personale. Në mesin e këtyre njerëzve bëjnë pjesë edhe pensionistët, të cilëve iu mungojnë librezat e punës, pa të cilin dokument ata nuk mund ta realizojnë të drejtën e tyre për pension të plotë, edhe pse ata posedojnë dokumente tjera, si dëshmi që kanë qenë të punësuar.

Zoti Kryeministër,

Si do ta zgjidhni problemin e pensionistëve, të cilëve ju mungon librezat e punës, pa të cilin dokument ata nuk mund ta realizojnë të drejtën e tyre për pension të plotë?

KRYETARI: Ju faleminderit! Zoti zëvendëskryeministër, e ke fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJFEDIN KUÇI: Ju faleminderit, zonja Pantina!

Ne kemi pasur këtë qëllim ta zgjedhim në dy drejtime. E para, që në çdo bisedë eventuale që bëhet në raport me Serbinë, edhe më herët është kërkuar që të merret dokumentacioni përkatës dhe, e dyta, besojmë që përmes evidencave që gjenden edhe në ndërmarrjet kudo që kanë punuar ata. Besoj që me Ligjin për pensionet do të

mundohemi ta rregullojmë, nga se në Ligjin për pensione, një qëllim prioritar i kësaj Qeverie është kategorizimi i pensionistëve, do ta quaja, apo ndarja e tyre që janë kontributdhënës apo pagues të kontributeve që kanë qenë më herët, dhe të tjerët që kanë pensionin si rezultat i moshës së arritur.

Besoj se në këtë proces do ta arrijmë këtë çështje që nuk është punë e lehtë. Këtu kemi probleme edhe me regjistër për kadastër dhe regjistra të tjerë, por besoj që do të jemi adekuat në këtë veprim.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë? Deputetja Myrvete Pantina, për pyetje shtesë.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit!

Për momentin, çfarë dokumentesh duhet të kenë pensionistët, të cilëve u mungojnë librezat e punës për të realizuar të drejtën e tyre?

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI – Ne jemi mundur që përmes Ligjit ta bëjmë kategorizimin. Momentalisht është një evidencë, e cila është gjendur, e cila nuk është në tërësi zyrtare, por jemi shfrytëzuar me të. Besoj që ndërkohë do ta bëjmë një dokument zyrtar. Por, të dhënat që janë aty, janë të përgjysmuara dhe veprimi që e kemi bërë deri më tani, nuk garantojnë qind për qind ligjshmëri.

KRYETARI: Ju faleminderit për përgjigjen!

Pyetja e radhës, deputeti Emrush Xhemajli, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotëri Alush Gashin. Deputeti Xhemajli, e ka fjalën!

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Të nderuar qeveritarë,

I nderuar ministër,

Pyetja ime ka të bëjë me një Ligj që është aprovuar më herët, por që ende nuk është duke u zbatuar. Konkretisht, çka ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e Ligjit për duhanin?

Ligji ka të bëjë me mbrojtjen e shëndetit të popullatës, sidomos të joduhanxhinjve dhe të moshave të ndjeshme dhe ka hyrë në fuqi me datën 9 janar 2007, do me thënë, gati para një viti. Edhe pse ka kaluar kjo kohë kaq e gjatë që Ligji ka hyrë në fuqi, gjatë një viti e gjysmë në praktikë nuk vërehet ndonjë ndryshim apo aktivitet i Ministrisë dhe i inspektorëve në zbatimin e këtij Ligji.

KRYETARI: Ministri Gashi e ka fjalën! E përgëzoj për entuziazmin për t'u përgjigjur!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!

I nderuari zoti deputet, duke ju falënderuar për interesimin tuaj, ju informoj për veprimet e ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë kundër pirjes së duhanit dhe masat e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit.

Ministria e Shëndetësisë e ka hartuar Ligjin kundër duhanit, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 3 tetor të vitit 2005 dhe ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2007.

Në bazë të Ligjit, obligim i Ministrisë ka qenë hartimi i udhëzimeve administrative dhe Ministria i ka hartuar që të tria udhëzimet administrative dhe, në kuadër të kompetencave, ka formuar Këshillin profesional me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Në fillim të punës, Këshilli ka hartuar Rregulloren dhe Planin e punës, që janë plotësuar dhe miratuar nga ana e Këshillit profesional. Këshilli, duke u mbështetur në planin e punës, gjatë kësaj periudhe ka ndihmuar Grupin punues dhe ka vendosur që fillimi i zbatimit të Ligjit të jetë gradual, ku në pjesën e parë do të jetë informimi i qytetarëve të Kosovës për obligimet të cilat dalin nga ky Ligj.

Janë bërë përgatitjet për aktivitetin e Ditës Ndërkombëtare të Duhanit, e cila është më 31 maj. Ju siguroj se ne jemi të përkushtuar që Ligji së pari të zbatohet në institucionet shëndetësore dhe arsimore të vendit tonë, si dhe në institucionet publike, siç është: Kuvendi i Kosovës. Në Kuvendin e Kosovës ky ligj ende nuk respektohet, e pastaj ne na krijohen pak probleme nëse në institucionin më të lartë nuk demonstron ky vullnet.

Puna e Inspektoratit Shëndetësor lidhur me këtë çështje e saktëson në tërësi veprimtarinë e tyre, dhe këta janë në terren për informimin e obliguesve për zbatimin e këtij ligji.

Një prej problemeve që qëndron për zbatimin e këtij ligji është se Industria e Duhanit jep shumë mjete për promovimin e duhanit, ndërsa buxheti i vendit tonë ka dhënë zero mjete për promovimin e zbatimit të këtij ligji. Andaj, kërkohet më shumë nga zyrtarët e vendit, që me aktivitetin e vet, me praninë e vet t'i ndihmojnë institucionet shëndetësore në zbatimin e këtij ligji. Në veçanti kishte për të qenë një gjest shumë i mirë sikur Kuvendi i Kosovës ta respektonte këtë ligj, sikur Qeveria e Kosovës ta respektonte këtë ligj dhe kjo do të ndihmonte më shumë që Ministria...

KRYETARI: Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë? Ju faleminderit!

Pyetja e radhës, deputeti Esat Brajshori, pyetje për Kryeministrin, zotëri Hashim Thaqin. Fjalën e ka deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë të nderuar,

Kryeministri nuk ndodhet këtu, zëvendëskryeministri shpresoj që do ta pranojë pyetjen time. Çështja është kjo: Sot, kur shfaqen rreziqe për tkurrjen e tërësisë tokësore të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, kujto Mitrovicën, Debëlliden, fshatrat e Anamoravës, në të cilat, sipas qytetarëve të kësaj ane, xhandarmëria serbe shpeshherë futet thellë në territorin e Kosovës. Sot kur digjen pikat doganore të shtetit të pavarur dhe sovran, i njohur nga shtetet më të fuqishme evropiane dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia, Kanadaja e të tjera, sot kur njerëz të politikës së Beogradit hyjnë në Kosovë, bëjnë trazira, zhvillojnë fushatë elektorale, duke i fyer dhe kërcënuar shqiptarët dhe kthehen prapa kur dhe si të duan, sot kur UNMIK-u bën koncesione me Serbinë në lidhje me zgjedhjet serbe në Kosovë, sot kur faza e tranzicionit, shkuarja e UNMIK-ut dhe ardhja e EULEX-it, është ngatërruar krejtësisht...

KRYETARI: Respektoni kohën!

Zoti zëvendëskryeministër, a ke përgjigjen? Respektojeni kohën, ju lutem!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit zoti deputet. Ne e ndajmë shqetësimin, besoj Qeveria e Kosovës, me ju dhe me të gjithë qytetarët e Kosovës, por duhet ta them se tërësia territoriale e Kosovës është e garantuar dhe e njohur ndërkombëtarësh. Njëkohësisht, tërësia territoriale është e garantuar dhe e lejuar që të mbrohet me të gjitha mjetet e parapara me Kushtetutë.

Ne jemi në bashkëpunim permanent me KFOR-in, jemi në bashkëpunim permanent edhe me Policinë e UNMIK-ut dhe Shërbimin Policor të Kosovës. Ne mund të themi se është ruajtur tërësia territoriale e Kosovës, ne mund të themi se është siguruar që kjo tërësi territoriale të jetë e paprekshme dhe dua të them se bashkëpunimi me KFOR-in dhe UNMIK-un dhe të tjerët ka qenë i shkëlqyeshëm. Ne jemi të interesuar që edhe brenda Kosovës të sundojë rendi dhe ligji, të ruhet pasuria individuale, individët dhe institucionet e Kosovës. Në këtë drejtim kemi marrë masat adekuate, por në fushën e sigurisë nuk jemi të vetëm, janë edhe të tjerët dhe jemi në koordinim të plotë.

Natyrisht, pavarësimi i vendit, tërësia territoriale dhe funksionimi demokratik i institucioneve janë preokupime permanente tonat.

KRYETARI: Ju faleminderit! Ka pyetje shtesë? Esat Brajshori e ka fjalën.

ESAT BRAJSHORI: Ta plotësoj veten, në mungesë të kohës së mëparshme. Zoti zëvendëskryeministër, nëse nuk është cenuar sovraniteti i vendit, djegia e dy pikave kufitare, është cenim sovranitetit apo nuk është? Ju faleminderit!

ZËVENDËSKRYEMISTRI HAJREDIN KUÇI: Besoj se ai ka qenë një veprim vandal, një veprim i ndaluar me Ligj dhe një veprim kriminal, për të cilin e falënderojmë KFOR-in që ka reaguar me kohë. Kemi kërkuar që të kthehen në pikat kufitare dhe duhet ta dallojmë. Ka elemente të cilat thonë që nga Qeveria e Serbisë stimulohen individë të caktuar për të bërë cenim të sovranitetit. Veprimet që bëhen nga brenda, janë më shumë veprime që janë kundër rendit kushtetues, kundër Ligjit.

Pra, sovraniteti i Kosovës është i garantuar dhe është i mbrojtur në tërësi. Mund të themi se është i garantuar dhe i mbrojtur përafërsisht ose më shumë se sa vendet që janë në rajon. Këtë garanci e kanë qytetarët e Kosovës, institucionet vendore të sigurisë dhe ato ndërkombëtare.

Çdo veprim ndaj sovranitetit, sovraniteti i takon popullit, do ta mbrojë populli dhe institucionet e tij.

KRYETARI: Ju faleminderit! E njoftoj deputeten Rita Hajzeri, që ka ardhur pak me vonesë, nëse do ta lexojë pyetjen për ministrin e Arsimit. Ministri paska shkuar. Mirë, atëherë deputeti Ismet Beqiri, pyetje për Kryeministrin, zotëri Hashim Thaçi. Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!
Përsëritje zëvendëskryeministër dhe ministra,
Kolegë deputetë,

Për të mos e zgjatur, se po mbesim pa i lexuar pyetjet, unë po kaloj drejtpërdrejtë në pyetje. Një çështje që e ka ngritur më herët zotëri Tali, unë do të doja nga Kryeministri, tash zëvendëskryeministri këtu, sqarim në këto çështje: A ka Memorandum të nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës, UNMIK-ut dhe Qeverisë së Serbisë për ndërtim të shtëpive në Badovc të Prishtinës, apo edhe diku tjetër në Kosovë për të zhvendosurit, të shpërngulurit e komunitetit serbë jashtë Kosovës?

Pyetja: Nëse po, në cilën datë është nënshkruar dhe nga kush dhe ndërtimi i 70 shtëpive për serbet në Badovc, a janë me leje ndërtimi, nëse po, kur dhe nga kush, nga cili organ kompetent është nënshkruar, sepse jam i sigurt që nuk kanë leje ndërtimi dhe edhe ky është një lloj agresioni nga Qeveria serbe, ndërtim në një shtet tjetër pa leje ndërtimi dhe pa koordinim me organet kompetente. Ju faleminderit!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Besoj që në seancën e parafundit, zëvendëskryeministri zotëri Ramë Manaj ka dhënë një përgjigje adekuate. Përgjigja ka qenë e plotë dhe e saktë. Ajo nuk konsiston se qeveria paraprake ka nënshkruar një memorandum, në me të qeverisë së Serbisë dhe të UNMIK-ut për ndërtimin e disa shtëpive për të kthyerit, si është thënë, por është fjala për të zhvendosurit brenda Kosovës.

Ndërkohë, ne kemi pasur takim edhe me kryetarin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, kryeministri, unë dhe zëvendëskryeministri, zoti Manaj, ata nuk e kanë lejen adekuate për punë. Besoj, kjo është e saktë dhe ata e kanë bërë një presion, në kuptimin, po e them, presion pozitiv edhe nga UNMIK-u dhe nga të tjerët që të jepet leja adekuate. Në mbledhjet e Kuvendit Komunal, nuk e di, ditët e fundit a është vendosur apo jo, por besoj që ende deri më sot nuk e kanë marrë lejen adekuate. Ne kemi qenë të kujdesshëm, e kemi lutur edhe kryetarin e Komunës, që të mos bëjë ndonjë veprim që ta tensionojë situatën, por sido që të jetë, respektimi i rendit dhe i ligjit, i kërkesave të parapara me ligj, do të ndodhë edhe për lagjen e Badovcit, edhe për të tjerat.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti, a ka pyetje shtesë? Deputeti Ismet Beqiri për pyetje shtesë.

ISMET BEQIRI: Edhe një herë ju lus, kur është nënshkruar dhe nga kush, sepse unë besoj që nuk ka një memorandum të tillë, e para. E dyta, po e përsëris për sqarim, ajo që e ka ngritur zoti Tali, nuk ka qenë, lokacioni ka qenë diku tjetër, ndërtimi është diku tjetër dhe, po e them, këtu është dyfish shkelje e vendimeve, në këtë rast edhe e respektimit të organeve komunale. Unë po e përsëris edhe njëherë, kur është nënshkruar, sepse mendohet që është një protokoll, që nuk është njësoj në mes të protokollit, nëse ka diçka këtillë. Kur është nënshkruar dhe nga kush është nënshkruar nga Qeveria e kaluar, kjo ka qenë pyetja ime. Më vjen keq, por përgjigjen nuk e mora, është shumë e përgjithësuar.

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI- Zoti Beqiri, besoj që e di, se ka qenë i njoftuar paraprakisht, besoj Qeveria paraprake e di, por unë po premtoj publikisht se të gjithë dokumentacionin adekuat do t'ua shpërndajmë të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Ne nuk e mohojmë atë, si Qeveri që jemi tash, nuk mund të themi, nga se obligimet e Qeverisë paraprake ne duhet t'i respektojmë, por duhet të them se do t'u njoftojmë me kohë, ndërsa tani ka kaluar çështja nga Qeveria e Kosovës, është në dorën e Kuvendit Komunal të Prishtinës. Ne nuk lëshojmë leje ndërtimi, lëshon Kuvendi Komunal. Jemi për koordinim të plotë. Do t'ju ofrojmë informacione dhe kopjen e atij memorandumit, protokollit, sido që e quajmë, do ta shihni me shkrim dhe nënshkrime adekuatë.

KRYETARI: Ju njoftoj, pasi po ankoheni në kohë, për pyetje nuk ka kohë më shumë se një minutë dhe për përgjigje më shumë se tre minuta.

Deputeti, Xhevdet Neziraj, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti. Deputeti, Xhevdet Neziri, e bën pyetjen.

XHEVDET NEZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Bëj pyetje për ministrin: Si është përbërja etnike e të punësuarve në Policinë e Kosovës dhe sa ju kushtohet kujdes dhe rëndësi për inkuadrim pjesëtarëve të komuniteteve, se kanë numër të vogël të punësuar në Policinë e Kosovës?

KRYETARI: Ju faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Qeverisë,

Zoti Neziraj,

Shërbimi Policor i Kosovës është një shërbim multi-etnik dhe përbërja e tij reflekton përbërjen e shoqërisë kosovare në përgjithësi. Shërbimi Policor i Kosovës, së shpejti Policia e Kosovës, ka procedura standarde të veprimit për sa i përket selektimit dhe rekrutimit, sepse prioritet i SHPK-së, para së gjithash, është profesionaliteti i pjesëtarëve.

Ministria e Punëve të Brendshme po bën thirrje të vazhdueshme, po them, për rekrutimin e pjesëtarëve të minoriteteve në SHPK, dhe deri më tash jemi të kënaqur me numrin e lartë të aplikimeve për anëtarësim në SHPK dhe besojmë se ky trend do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Më lejoni të përmend gjendjen ekzistuese të përbërjes së Shërbimit Policor të Kosovës: 9.98% kemi nga minoriteti serb, 5.58% nga minoritetet e tjera.

Ashkali janë 21 pjesëtarë; boshnjakë 213; kroatë 3; çerkez 5; egjiptianë 7; goranë 38; maqedonë 1, romë 22; serbë 708 dhe turq 87 pjesëtarë, pra gjithnjë me tendencën, siç thashë, dhe me thirrjen e vazhdueshme për rekrutim të mëtutjeshëm, duke respektuar edhe interesimin e tyre dhe në plan të parë profesionalizmin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti Neziri, a ka pyetje shtesë?

XHEVDET NEZIRI: Ju faleminderit! Unë do ta bëj edhe një pyetje. E kam ditur se numri është i vogël i komunitetit egjiptas, por dua të njoftoj se që dy vite Burim Feta, Agim Bajrami, Rustem Isufi dhe Ukë Avdyli, pjesëtar të komunitetit egjiptas, kanë kaluar të gjitha testet dhe nuk janë ftuar që të shkojnë në shkollë në Vushtrri. Dua të

njoftoj që, ndoshta, pas suspendimit të disa policëve që nuk po pranojnë të punojnë në Shërbimin Policor, do të ketë vend për këta 4 pjesëtarë të komunitetit egjiptas. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti Ministër, keni përgjigje?

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Më lejoni të konfirmoj edhe njëherë se ne po bëjmë përpjekje për përfaqësim adekuat. Çështja e rekrutimit është çështje e standardeve profesionale të Policisë, është departament që po punon në përputhje me respektimin e rregulloreve të brendshme. Ne aktualisht po punojmë në një rishikim të tërësishëm funksional të Policisë, në mënyrë që të përshtatemi edhe me ligjin e ri, edhe me përfaqësimin e juaj. Por, për të gjitha çështje që mund të ketë ankesa konkrete, e tjera, ato do të trajtohen në mekanizmat e veçantë të Policisë dhe ne do të interesohemi që të respektohen të gjitha ato. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Tani do të kemi 15 minuta pushim, për kafe.

(Vazhdimi i seancës pas pauze)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, në sallë janë të pranishëm 63 deputetë, kështu që mund të vazhdojmë punën.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale**

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 27 shkurt 2008. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, si vijon:

- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale – me amendamentet e propozuara, nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve;
- Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin Lgjit për ekzekutimin e sanksioneve penale – me amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë implikime buxhetore;
- Komisioni për Legjislacion, si komision kryesor, funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit kanë bazë juridike në Kornizën kushtetuese dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij, me amendamentet e propozuara;
- Komisioni funksional dhe raportues i ka propozuar 8 amendamente.

Para se të procedojmë me miratimin e amendamenteve të propozuara, ftoj kryetarin ose raportuesin e komisionit funksional, nëse e sheh të nevojshme, për ta arsyetuar raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje e nderuara ministre,

Përshëndetje kolegë të nderuar deputetë,

Komisioni brenda afatit të paraparë ligjor ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe gjatë shqyrtimit ka marrë parasysh edhe propozimet të cilat kanë dalë nga seanca e parë plenare dhe, natyrisht, edhe nga sponsorizuesi i cili është dëgjuar.

Me këtë rast, ne kemi kërkuar nga Ministria e Drejtësisë që të japë disa sqarime rreth disa propozimeve, e sidomos rreth fjalëve: “rehabilitim”, “risocializim”, “riedukim”. Nga sponsorizuesi është propozuar fjala “riedukim” të përdoret në ekzekutimin e sanksioneve penale, mirëpo kjo nuk iu ka përshtatur terminologjisë sepse fjala “riedukim” ka qenë vetëm për moshën madhore dhe këtu është fjala për të rritur dhe ne kemi përdorur fjalën “rehabilitim” duke u bazuar në Kodin penal të Kosovës, në nenin 34.1 që te qëllimet e dënimit parasheh edhe rehabilitimin si institucion.

Mirëpo, meqë ka laramani edhe në Ligjin e ekzekutimeve të sanksioneve penale dhe në Kodin penal, ne ishim të mendimit që edhe me ministren e Drejtësisë që ndoshta mund të përdoret në vend të amendamentit të parë fjala edhe “riintegrim” që do t’i shkonte për shtati, nëse pajtohen deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Për çështje të tjera nuk kemi ndonjë vërejtje konkrete dhe mbesim prapa propozimit që kemi vendosur në mënyrë unanime në komisionin funksional dhe prapa amendamenteve që kemi propozuar dhe i rekomandojmë Kuvendit të Kosovës që ta aprovojë Ligjin me amendamentet e propozuara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Le të deklarohej ministrja e Drejtësisë.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar, zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fjala “rehabilitim” mund të përdoret në kontekste të ndryshme, varësisht prej situatave të ndryshme.

Në Kodin penal të Kosovës, në nenin 87, fjala “rehabilitim” nënkupton “shlyerjen e dënimit nga evidenca e të dënuarve”.

Gjithashtu, në Kodin penal, në nenin 34, thuhet se “qëllimi i dënimit është rehabilitimi”. Mirëpo, në nenin 3 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, i cili tani është objekt shqyrtimi për ndryshim dhe plotësim, thuhet se “ekzekutimi i sanksioneve penale ka për qëllim riintegrimin e të dënuarit”.

Prandaj, unë pajtohem me kryetarin e Komisionit, zotin Bahri Hyseni që në vend të fjalës “rehabilitim” në tërë tekstin të përdoret fjala “riintegrim”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pasi nuk ka propozime të tjera, do të shkojmë sipas radhës, duke pasur parasysh propozimin që e kishte kryetari i komisionit funksional dhe ministrja e Drejtësisë.

Kalojmë në votimin e amendamentit 1.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:
A ka ndokush që nuk e ka kartelën? Një.
A jeni “për”? Faleminderit!
Do të thotë, prezent janë 73 deputetë.
Sipas votimit me elektronikë, “për” janë 67+1, do të thotë 68 vota, 1 “kundër” dhe 1 abstenim.
Konstatoj se u miratua amendamenti 1.

Kalojmë në amendamentin 2.
Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për të votuar. Votojmë tash:
A ka deputetë “për” që i mungon kartela? Një. Faleminderit!
A ka kush “kundër” që i mungon kartela? Nuk ka.
Abstenim? Faleminderit!
Prandaj, konstatoj se me 71 votë “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.
Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:
A ka kush që i mungon kartela? Do të thotë se jeni “për”? Faleminderit!
A ka ndokush pa kartelë, që është “kundër”?
Abstenim? Nuk ka. Faleminderit!
Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.
Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash:
Pa kartelë “për”? Një. Faleminderit!
“Kundër”?
Abstenim? Nuk ka. Faleminderit!
Me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.
Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:
Kush është “për”? Pa kartelë? Një. Faleminderit!
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Faleminderit!
Me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.
Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:
Kush është “për”? Pa kartelë? Një. Faleminderit!
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Faleminderit!
Me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.
Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:
Kush është “për”? Pa kartelë?
“Kundër”?
Abstenim? Faleminderit!
Me 68 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8 dhe i fundit.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

A ka “për”, pa kartelë? Një. Faleminderit!

“Kundër”?

Abstenim? Nuk ka. Faleminderit!

Me 63 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet edhe amendamenti 8.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për ta votuar tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash:

Pa kartelë, “për”? Faleminderit.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Faleminderit!

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, konstatoj se Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë**

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 27 shkurt 2008.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, si vijon:

- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për deklarimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për deklarimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- Komisioni për Legjislacion, si komision kryesor funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për deklarimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit kanë bazë juridike në Kornizën kushtetuese dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.
- Komisioni funksional dhe raportues i ka propozuar 17 amendamente.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, ftoj kryetarin ose raportuesin e komisionit funksional, nëse e sheh të nevojshme, të arsyetojë raportin me rekomandime.

Këtë të drejtë e kanë edhe kryetarët e komisioneve kryesore.

Meqenëse nuk paraqitet askush për diskutim, atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

A ka kush pa kartelë? Nuk ka. Faleminderit!

Me 63 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti nr.1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 71 vota “për”, asnjë abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Urdhëroni, zonja ministre! Fjalën e ka ministrja e Drejtësisë, zonja Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Mendoj se te amendamenti 4, pika 6, fjala “gjqqtarë” të zëvendësohet me “gjqkatësit”. Është çështje gjuhësore dhe ua kisha lënë gjuhëtarëve që këtë ta shqyrtojnë, kështu që nuk e kisha parë si amendament. Në Kushtetutë ndryshe quhen gjyqtarët, kurse këtu janë “gjqkatësit”. Prandaj, ua kisha lënë këtë gjuhëtarëve, sepse është çështje gjuhësore.

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar! Është amendament të cilin e kanë vendosur gjuhëtarët, sepse nuk kanë pranuar të jetë “gjqqtarë”, mendojnë se duhet të jetë “gjqkatës” dhe kjo duhet të vlejë edhe në të ardhmen për të gjitha ligjet të cilat do të procedohen. Është çështje që gjuhëtarët e kanë shqyrtuar këtë.

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është lajmëruar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Zoti Kryetar, “gjqkatës” duhet medoemos të përdoret dhe grupi për redaktimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës e ka përcaktuar termin “gjqkatës” pas konsultimit të fjalorëve, të enciklopedive dhe të rregullave gramatikore. Folja “gjqkim”, së andejmi “gjqkon”, “gjqkon në gjqkatë”. Nuk thuhet “Gjqqi suprem”, por “Gjqkata supreme”, nuk thuhet “Gjqqi i qarkut” por “Gjqkata e qarkut”, “Gjqkata themelore”. Pra, “gjqkon gjqkatësi” dhe është shprehje e përshtatshme shqipe, e logjikshme, e pranueshme. Komisioni Legjislativ e ka përcaktuar plotësisht, drejtësisht, prandaj angazhohem që gjithmonë, tash e tutje të përdoret “gjqkatës” e jo “gjqqtar”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka kërkuar deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Po, në nenin 3, këtu përkufizohet fjala “zyrtar i lartë publik”, ndërkaq në amendamentin 1, propozohet që titulli i ligjit të jetë “zyrtarë publikë të lartë”. E njëjta gjë ndodh edhe tek neni 7.2, përkatësisht amendamenti 10, që propozon që para fjalës “publikë” të vihet fjala “i apo e lartë” dhe kështu thuhet “zyrtarët e lartë publikë” konform qysh ka qenë ligji më parë, ndërkaq me amendament propozohet që të jetë e kundërta “zyrtarët publikë të lartë”. Këtu ose duhet të jetë konform edhe titulli i ligjit dhe

të mbetet “zyrtarët e lartë publikë”. Këtu propozohet “zyrtarë publik të lartë” të ndryshohet titulli ose emri i ligjit, ndërkaq më poshtë...

KRYETARI: E ke përshpejtuar pak, sepse nuk jemi në atë amendament, jemi në amendamentin numër 4. Kjo është pjesë e amendamentit 5. Një herë do të shkojmë në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të amendamentit 4.

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Tani vlen sqarimi që e dha deputeti Hajdin Abazi.

Çfarë mendimi ka Komisioni? Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar! Unë mendoj që e kemi dhënë sqarimin. Edhe kjo ka qenë terminologji që më tepër gjuhëtarët e kanë përdorur dhe kjo “publikë” të jetë para se të përcaktohet i “lartë” i “ulët” e kështu me radhë. Kjo qëndron në krejt Projektligjin. Kështu është edhe i shkruar, nuk e di ku qëndron dilema.

(Reagim)

Pas fjalës “publikë” t’i shtohet “i lartë”. Kjo është shumë e qartë, nuk e di që ndryshon diçka kjo.

KRYETARI: Deputeti Hajdin Abazi, e ka fjalën.

HAJDIN ABAZI: Për shembull, kjo bien në kundërshtim me amendamentin 10, ku propozohet, neni 7 paragrafi 2, që para fjalës “publikë” të vihet fjala “e lartë”. Do të thotë, Ligji është “zyrtarët publikë të lartë” kurse këtu propozohet të jetë “zyrtarët e lartë publikë”. Le të jetë uniforme kjo. Nëse thuhet përpara “publikë” atëherë edhe këtu le të vlejë ajo “publikë”, e jo një herë “publikë” e një herë “i lartë” dhe ta ndërrojnë vendin.

KRYETARI: Faleminderit! Unë kisha kërkuar ndihmë të një juristi, sepse mendoj se kjo që e tha Hajdin Abazi është më e drejtë. Urdhëroni, zoti Bahri.

BAHRI HYSENI: Është vetëm procedim që e ka lëshuar administrata gabim, sepse kjo u qartësua, kudo do të jetë ajo “e lartë” përpara. Domethënë, është një procedim që del si gabim nga administrata, të them.

(Reagim)

KRYETARI: Amendamenti 10, thuhet: fjala “e lartë” vihet para fjalës “publike”.

(Reagim)

Dhe, cila është kërkesa definitive? “I lartë” përpara, jo. E ka fjalën Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Duhet të qëndrojë, të jetë “zyrtarët publikë të lartë”, kudo. Do të thotë “publikë të lartë”.

KRYETARI: Atëherë, kur të shkojmë te neni 10, duhet ta ndryshojmë.

BAHRI HYSENI: Absolut! Do të thotë, është vetëm një gabim i administratës që, domethënë, deri në fund nuk e ka përcjellë këtë “publikë të lartë” dhe është lëshuar kjo fjalë.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Jemi te amendamenti numër 5.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

A ka deputetë pa kartela? Nuk ka.

Me 65 vota “për”, 2 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 73 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Tash mund të shtojmë se amendamenti 10 i përshtatet amendamentit numër 5. Këtu është ndryshimi. Atëherë, me këtë ndryshim do ta votojmë amendamentin 10.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 66 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Urdhëroni! Jemi në procedurën e votimit. E ka fjalën deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Po atëherë, le të ndryshohet edhe këtu, për mosdeklarim të marrjes së detyrës për “zyrtarë të lartë publik” sepse po paraqitet prapë kjo, para se të votojmë.

KRYETARI: Mirë, edhe amendamenti 17 mund të shkojë konform të amendamentit 5 dhe 10.

Do të thotë, do të votojmë me këtë ndryshim.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime miratohet amendamenti 17.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për të votuar tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

(Reagime nga salla)

Po, do ta ndryshojmë dhe e bëjmë “publikë të lartë”!

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 27 shkurt 2008.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, si vijon:

- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

- Komisioni për Legjislacion, si komision kryesor funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale dhe ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit kanë bazë juridike në Kornizën kushtetuese dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.
- Komisioni funksional dhe raportues i ka propozuar 4 amendamente.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, ftoj kryetarin ose raportuesin e Komisionit funksional, nëse e sheh të nevojshme të arsyetojë raportin me rekomandime.

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi qëndron prapa amendamenteve që i ka propozuar, mirëpo vetëm kërkon që kjo fjala “e përkohshme” të mos ekzistojë më, pasi që Kushtetuta e Kosovës nuk i njeh këto kode si të përkohshme. Ky Projektligj është proceduar shumë më herët, që një muaj, prandaj kërkojmë që fjala “e përkohshme” të hiqet dhe të jetë “Kodi i procedurës penale të Kosovës”. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo nuk është në asnjë amendament. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Nuk kemi bërë amendament. Thashë se ky projektligj është proceduar një kohë më herët, diku para një muaji dhe ka qenë “Kodi i përkohshëm penal i Kosovës” dhe duke i përcjellë në bazë të Kornizës kushtetuese nuk kemi pasur mundësi të bëjmë amendament. Mirëpo, meqë tani po i afrohem afatit kur hyn në fuqi Kushtetuta e Kosovës, fjalët “e përkohshme” mendoj se duhet të hiqen. Dhe sot, nëse voton Kuvendi i Kosovës, do të ishte shumë normale që fjala “e përkohshme” të mos ekzistojë. Mirëpo, mund ta presim edhe zgjidhjen tjetër. Në momentin kur futet në fuqi Kushtetuta e Kosovës, ai nuk i njeh kodet si të përkohshme, por i njeh si të përhershme.

KRYETARI: Atëherë, ky është amendament i ri.

BAHRI HYSENI: Po, natyrisht!

KRYETARI: Domethënë, prej katërve bëhen pesë amendamente.

Meqenëse pika 10 thotë: “shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale” pa atë “të përkohshëm”, atëherë, nëse është në raport, po e shtojmë këtë amendament që Ligji të quhet “Kodi i procedurës penale”, pa atë “të përkohshëm”. A mund të jetë ky amendamenti numër 1. Urdhëroni, zonja ministre!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Mendoj se para se të fillojë të zbatohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ne nuk mund të punojmë në bazë të asaj Kushtetute, kështu që sot punojmë akoma në bazë të Kornizës së përkohshme. Prandaj, tani për tani nuk ka vend ndryshimi i titullit të Kodit dhe mbetet Kodi i vjetër dhe objekt ndryshimi është ai kod i vjetër, me atë emër.

Kam edhe një koment tjetër, lidhur me nenin 1, Amendamenti 1. Është propozuar si zgjidhje tjetër, në vend të tekstit të propozuar në Ligjin për ndryshim dhe plotësim, ku thuhet: “përfshirë atë që është nën minimumin e përcaktuar me ligj”, tani në amendament propozohet “por jo nën minimumin e përcaktuar me ligj”. Meqë ky ndryshim bëhet si rrjedhojë e futjes së pranimi të fajësisë, atëherë mendoj se nuk mund të ndryshohet “por jo nën minimumin e përcaktuar me ligj” sepse edhe ashtu, edhe pa pranimin e fajësisë gjykatësi ka diskrecionin që, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat e rastit të kryesit të veprës penale, ta zbusë dënimin deri në minimumin për veprën e caktuar penale. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për zbutjen e dënimit deri në minimum të llojit të dënimit, por deri në minimum të dënimit ose nën minimum të dënimit për veprën e caktuar penale, kështu që nuk ka vend ky amendament këtu.

KRYETARI: Mirë, fjalën e ka kryetari i Komisionit Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Jo, është mirë ta qartësojmë. Propozuesi i ndryshimit të amendamenti ka propozuar që nëse dikush nga i akuzuari pranon të bashkëpunojë me Prokurorinë dhe në këtë rast, bile, edhe me policinë, që është edhe një amendament tjetër, t’i shqiptohet një dënim nën minimumin e paraparë me ligj dhe kjo do t’i bjerë në situatë që gjykatat të mos jenë të pavarura me rastin e vendosjes dhe të vendosin kundër ligjit. Prandaj, Komisioni unanimisht ka vendosur që, pavarësisht a bashkëpunon ai me institucionin në fjalë, nuk mund t’i shqiptohet dënim nën minimum. Mund t’i shqiptohet një dënim deri në minimum, mirëpo asses nën minimumin e paraparë me ligj. Prandaj, zonja ministre, duhet ta keni parasysh që ju keni propozuar që t’i shqiptohet dënim nën minimum të paraparë me ligj dhe ne si Komision mendojmë që nuk ka mundësi të shqiptohet dënim nën minimum, por mund të shkohet deri në minimum, kurse nën minimum nuk ka mundësi, sepse ligji nuk e lejon. Prandaj, mbesim prapa propozimit si Komision.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Kryetar i nderuar,

Kolegë të nderuar e të respektuar,

Do ta shfrytëzoj oportunitetin edhe këtu ta them me bindje, jo kështu ad-hoc, por edhe pas konsultimeve edhe me kolegët më eminentë se ky projektligj nuk do të duhej fare të miratohej, sepse e favorizon ekzekutivin në disfavorin e gjyqësorit, e cenon parimin e ndarjes edhe të kontrollimeve reciproke të tri pushteteve dhe hap mundësi që edhe legalisht prokurori, i cili do të duhej ta ndiqte me konsekuencë edhe me konsistencë krimin, kriminelin e kriminelët e aktet kriminale, që të bashkëpunojë, të kollaborojë, të bëjë koncesione në disfavor të ligjit dhe të ligjshmërisë me kriminelin dhe të favorizohet. Do të thotë, detyra elementare e Prokurorisë është ndjekja e pa kurrfarë kompromisi e krimit, e kriminalitetit, e jo edhe të bëjë kontrata me të apo me ta dhe t’i favorizojë. Prandaj, kjo është kësisoj. Nën dy, ju lutem, unë vlerësoj qëndrimin e zotit Hyseni të pranueshëm se e kemi diskutuar në Komisionin Legjislativ gjerë e gjatë dhe kemi arritur te një konkluzion unanimit që do të duhej, po që se nuk do të miratohej kjo e para, atëherë së pakut kjo e dyta.

Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka ministrja Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Amendamenti 1, pikërisht ka të bëjë me nenin 4.1 (ii), pra, për pajtimin e prokurorit publik t'i rekomandojë gjykatësit dënim më të butë, duke përfshirë atë që është nën minimumin e parashikuar me ligj. Ndoshta, këtu do të duhej të shtohet edhe fjala për veprën e caktuar penale, kurse sa i përket dëshmitarëve, bashkë të akuzuarve bashkëpunëtorë, këtu nuk flitet në këtë amendament, prandaj unë nuk e shoh oportune, nuk e shoh të arsyeshme tash të diskutohet për të akuzuarit bashkëpunëtorë. Kurse, sa i përket mosmiratimit të ligjit, ky ligj është miratuar në lexim të parë edhe nuk e di pse tash kontestohet edhe nuk mund të tërhiqet nga procedura pas miratimit në lexim të parë.

KRYETARI: Faleminderit!

Një sqarim, në këtë fazë deri në miratim të Kushtetutës, Kodi do të quhet: "Ndryshimet e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës", domethënë, nuk është amendament i ri.

Tani kalojmë në votim, votojmë propozimin e Komisionit.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 62 vota "për", 4 vota "kundër" dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti nr. 1.

Amendamenti nr. 2

Urdhëro, fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

Për amendamentin numër 2.

GANI BUÇINCA: Ju përshëndes të gjithëve. Unë e kam kundërshtuar edhe në parim nenin i cili e thyen etikën gjyqësore dhe Prokuroria i detyron të akuzuarit të bëhen bashkëpunëtorë. E kam kontestuar edhe atëherë, e kontestoj edhe sot. Implikimet në sigurinë e personave dhe në funksionimin e gjykatave do të jetë shumë të mëdha dhe propozimi i ardhur që i akuzuari, i pandehuri të fitojë statutin e bashkëpunëtorit me Prokurorinë, është një prej përvojave më të këqija të gjyqësorëve të shteteve demokratike. Atëherë e kam kundërshtuar e kundërshtoj edhe sot, për arsye se nuk është në harmoni me të drejtat e njeriut dhe e thyen etikën elementare njerëzore. Ju kisha lutur të votoni kundër.

KRYETARI: Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, për amendamentin 2.

Votojmë tash:

Me 51 vota "për" 8 "kundër" dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti nr.2

Amendamenti nr. 3

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Jo, unë mendoj vetëm ta bëjmë një sqarim. Kodin penal ne e kemi ndryshuar dhe e kemi shti një institut të ri për pranimin e fajësisë, prandaj nuk kemi shkas, s'kemi mundësi të kthehemi prapa...

KRYETARI: Po është kryer ajo.

BAHRI HYSENI: Prandaj, këtu nuk ka dilemë, por vetëm edhe një sqarim për ministren. Pikërisht neni më poshtë tregon për bashkëpunëtorët.

KRYETARI: E kemi amendamentin numër 3, ju lutem mos i ngatërmoni. Vetëm nëse është fjala për amendamentin numër 3 e merrni fjalën, për të tjerat jo.

BAHRI HYSENI: Amendamenti numër 3 e rregullon këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar edhe Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani predsjedniče,
Uvažene kolege poslanici,

